



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 465/3 prot.

Tiranë më 13.04.2018

**REKOMANDIM**

Nr. 14, datë 13.04.2018

**PËR KONTROLLUESIN "ADRA STUDIO SHPK"**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 31 pika 1, gërma a/1 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit Nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Adra Studio shpk",

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit Nr.93 datë 07.03.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Shoqëria "Adra Studio shpk", me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Shoqëria "Adra Studio shpk"

Në funksion të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Shoqëritë e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, janë kontrollues të cilët mbledhin dhe përpunojnë të dhëna personale të kategorive "punonjës dhe klientë".

Kontrolluesi Shoqëria "Adra Studio shpk", është subjekt juridik me NIPT: K31716007L dhe objekt aktiviteti "Aktivitetet në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme etj..."

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, sipas procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim në datë 28.03.2018, u konstatua se:

1. Kontrolluesi ka "Njoftuar" në lidhje me përpunimin e të dhënave personale. Nga verifikimi i të dhënave të deklaruar nga kontrolluesi pranë Zyrës së Komisionerit, konstatohet se Njoftimi është jo i plotë dhe ka nevojë të përditësohet, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit.

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
3. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar *"Deklaratë Konfidencialiteti"* me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale. Në kontratat individuale të punës neni 9.3, janë parashikuar klauzola për ruajtjen e sekretit mbi çdo informacion mbi të cilin është vënë në dijeni gjatë punës së tij;
4. Në kontratat me të tretë (Banka) me objekt: ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, parashikohen detyrime për ruajtje të konfidencialitetit, por këto kontrata nuk janë hartuar sipas aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi *"Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi."*  
Subjektet e të dhënave të cilët ju përpunohen të dhënat personale janë *"klientë"* dhe *"punëmarrës"*.

Pas konstatimeve të mësipërme rezultojnë se:

1. Lidhur me pikën e parë të konstatimit, (depozitimin e *"Formularit të Aplikimit"* për realizimin e *"Njoftimit"* pranë Zyrës së Komisionerit), në nenin 21 *"Përgjegjësia për të njoftuar"* në pikën 1, të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar thuhet: *"Çdo kontrollues duhet të njoftojë komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë"*. Fakti që kontrolluesi ka depozituar formularin e njoftimit por nuk e ka përditësuar atë përbën shkelje administrative të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"*.
2. Lidhur me pikën e dytë (hartimin e një rregulloreje për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale) në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar, në pikën 2/1 përcaktohet se: *"Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera"*.
3. Lidhur me pikën e tretë të konstatimit nënshkruar *"Deklaratë Konfidencialiteti"* me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale në nenin 28 *"Konfidencialiteti i të dhënave"* të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 *"Për mbrojtjen e të dhënave personale"* i ndryshuar përcaktohet se: *"Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj"*. Fakti që kontrolluesi ka parashikuar klauzola për ruajtjen e sekretit në kontratat individuale të punës, nuk mjafton për të siguruar një mbrojtje të plotë në këndvështrim të legjislationit për mbrojtjen e të dhënave personale.

4. Lidhur me pikën e katërt të konstatimit, (hartimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronave duke parashikuar rregulla specifike për ruajtjen e konfidencialitetit) në nenin 20 të Ligjit Nr.9887 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, parashikohen ashtu si për kontrolluesit dhe *“Detyrimet e përpunuesit”* si më poshtë:

1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

- a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi;
- b) të marrë të gjitha masat e sigurisë, sipas këtij ligji dhe të punësojë operatorë, të cilët kanë detyrimin për ruajtjen e fshehtësisë;
- c) të krijojë, në marrëveshje me kontrolluesin, kushtet e nevojshme teknike dhe organizative për përmbushjen e detyrimeve të kontrolluesit, për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale;
- ç) t'i dorëzojë kontrolluesit, pas përfundimit të shërbimit të përpunimit, të gjitha rezultatet e përpunimit dhe dokumentacionit, që përmban të dhëna ose t'i mbajë apo t'i shkatërrojë ato me kërkesë të kontrolluesit;
- d) të vërë në dispozicion të kontrolluesit të gjithë informacionin e nevojshëm, për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet, që rrjedhin sipas shkronjave të mësipërme.

Detyrimet e pikës 1 të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, përcaktohen në kontratën e shkruar të kontrolluesit me përpunuesin të cilat shërbejnë si model për hartimin e kontratave në vijimësi. Një fakt i tillë është materializuar në pikën 5/b dhe në pikën 9 të Udhëzimit nr.19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi *“Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*.

Faktet e mësipërme (nevoja e përditësimit të *“Formularit të Njoftimit”*, mungesa e rregullores specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, mungesa e *“Deklaratë Konfidencialiteti”* me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale, mungesa e kontratave me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit), përbëjnë shkelje të dispozitave 20, 22, 27 dhe 28 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Nisur nga fakti që kontrolluesi u tregua bashkëpunues me grupin e kontrollit si dhe tregoi gatishmëri për përmbushjen e menjëhershme të konstatimeve, Zyra e Komisionerit vlerëson se dalja me akt rekomandues plotëson më së miri përfundimin e këtij kontrolli

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar,

## REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Adra Studio shpk”, të përditësoj “Formularin e Njoftimit”.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Adra Studio shpk”, të hartojë rregullore specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në përputhje me veprimtarinë e tij.
3. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Adra Studio shpk”, të nënshkruaj “Deklaratë Konfidencialiteti” me punëmarrësit të cilët kanë akses në përpunimin e të dhënave personale.
4. Në zbatim të nenit 20 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, kontrolluesi “Adra Studio shpk”, të hartojë kontratat me të tretë, për ofrimin e shërbimeve të vlerësimit të pronës, sipas formatit të Aneksit nr. 1 të Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 mbi “Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi.”.
5. Kontrolluesi “Adra Studio shpk”, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në këtë Rekomandim, brenda afatit 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi “Adra Studio shpk”, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
7. Në rast mos përbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 13.04.2018

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

